

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konfirmohet identiteti i 3 viktimave nga varret masive në Zubin Potok, i perkasin "Grupit të Intelektualëve"
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/19/konfirmohet-identiteti-i-3-viktimave-nga-varret-masive-ne-zubin-potok-i-perkasin-grupit-te-intelektualeve/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:43:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:39:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b79cd755793802dee5d6ba48057fd632452e35a67c1ee64219d099a77e1e0afc
TEKSTI	deead7ac56d035e55aeb4bf403d1905832b1edc467f645e69a0341e014806843
PAMJA	2b989946f2827618bde8bb30d28e39bdf4f1a92b8315a7d8b7a0c613db768e5b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d519be704c1679d4890f42a2c3376fc21a74c11f808079aa7c0c6231b66dc6ea
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aea7d85c4e1ffedb330a4f0c595bceb62319ead8019dd1bf570799cb9f2d4d85
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d519be704c1679d4890f42a2c3376fc21a74c11f808079aa7c0c6231b66dc6ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

Konfirmohet identiteti i 3 viktimave nga varret masive në Zubin Potok, i përkasin “Grupit të Intelktualëve”

14:39:19/09/2026 në RAJONI



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar të shtunën se është konfirmuar identiteti i tri viktimave pas zhvarrimit të mbetjeve mortore të zbuluara në varreza masive në lokacione të ndryshme në veri të Kosovës.

Kurti shkroi në Facebook se raportet e ADN-së kanë konfirmuar se tri viktimat i përkasin grupit të njohur si “Grupi i Intelktualëve”, kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Kryeministri nuk tregoi me emër dhe mbiemër se kush ishin viktimat, por tha se familjet e tri viktimave të identifikuara janë njoftuar qysh sot.

Njoftimi i tij vjen gati dy muaj pasi u zbuluan tri varre masive në këtë komunë në veri të vendit, ku u gjetën mbetje mortore të së paku 23 njerëzve.

Lexo edhe:

[Arrestohet një i dyshuar për krime lufte në Zubin-Potok](#)[Mbetjet mortore në Zubin Potok/ Dërgohen në Hagë 10 mostra për identifikim përmes ADN-së](#)

Në fund të muajit të kaluar, autoritetet kosovare i dërguan në Hagë të Holandës mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Kurti tha se Kosova pret t’i pranojë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së “në ditët dhe javët në vijim”.

“Me shpresën që edhe familjet e tjera të marrin përgjigjet që presin prej 27 vitesh. Asnjë përgjigje nuk mund ta shuajë dhimbjen e humbjes, por njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për të mësuar fatin e më të dashurve”, tha Kurti./ REL

Etiketa: varre masive Zubin Potok

TË GJITHA



Korrupsioni mbetet 'thembra e Akilit' në Kadastër

14:41 - 19/09/2026



Konfirmohet identiteti i 3 viktimave nga varret masive në Zubin Potok, i përkasin “Grupit të Intelktualëve”

14:39 - 19/09/2026



Berisha komenton ndryshimet në qeveri: Demo i gatuar me bandat, ka lidhje të afërta me kreun e SPAK

14:21 - 19/09/2026



VIDEO/ Njoftoni Kreshnikun e Transportit Rrugor të hedhi një sy nga Kolaudimi se po helmon Tiranën

13:59 - 19/09/2026



Vrau gruan me thikë, vetëdorëzohet Hysni Patushi

13:39 - 19/09/2026




Aksident në Fier-Patos, motoristi i picave mbetet i plagosur

13:20 - 19/09/2026



Grizzly fundos Raiffeisenin, aksionet e bankës ranë me 9% brenda ditës

13:07 - 19/09/2026



Arrestohet një i dyshuar për krime lufte në Zubin-Potok

16:06 : 03/09/2026



Mbetjet mortore në Zubin Potok/ Dërgohen në Hagë 10 mostra për identifikim përmes ADN-së

18:24 : 28/08/2026



Kurti: 23 mbetjet mortore në Zubin Potok përkojnë me "grupin e intelektualëve"

15:43 : 24/08/2026



Arsenali në Zubin Potok, drejtori i Policisë: Mund të jenë përdorur në masakrën e "Grupit të Intelektualëve"

20:06 : 20/08/2026



FOTO/ Policia e Kosovës sekuestron arsenal armësh në veri të Mitrovicës

16:44 : 20/08/2026



Varrezat masive në Zubin Potok, gjenden mbetjet kockore të 23 personave

18:01 : 19/08/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

